

Kumtesë për media
15 nëntor 2021

Fondi i Grave të Kosovës mbështetë tetë organizata me rreth 80,000€

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) shpalli sot organizatat përfituese të rundit të 16 të granteve të Fondit të Grave të Kosovës (FGK). Për herë të parë, tetë organizatave anëtare të RrGK-së të cilat janë të përkushtuara për avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Kosovë, do t'u ofrohet [mbështetje organizative](#), nga Trusti Sigrid Rausing, në vlerë 79,740€.

Këto grante do të kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin e [Strategjisë aktuale të RrGK-së për vitet 2019-2022](#), hartuar nga anëtarët e RrGK-së, me qëllim të adresimit të përbashkët të pabarazive gjinore të cilat ato i kanë identifikuar në Kosovë.

Organizatat përfituese të rundit të 16 janë:

• In Time	10,000.00€
• Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës	10,000.00€
• Moravski Biser	9,762.00€
• OJQ "Drugëza"	9,993.00€
• OJQ "Gruaja Hyjnore"	9,998.00€
• OJQ "Me dorë në zemër"	9,999.00€
• Shoqata e Juristëve Norma	9,998.00€
• Womens Alliance for Integration	9,990.00€

Fondi i Grave i RrGK-së ndan grante të vogla për organizata të grave të cilat nuk kanë qasje në burime tjera të financimit dhe të cilat punojnë për të drejtat e grave dhe barazi gjinore, duke pasë prioritet grupet në zonat rurale, dhe grupet e marginalizuara. Që nga viti 2012, FGK ka ndarë 224 grante, dhe ka mbështetur 111 organizata me grante në vlerë prej 1,200,519€.

Përveç Trustit Sigrid Rausing, në vitin 2021 FGK mbështetet gjithashtu edhe nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, Agjencia Austriake për Zhvillim, si dhe Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

